

## **Thirrje e hapur për bashkë-krijimin e "Zgjidhjeve të Zgjuara" me komunitetet rurale (FUTURAL)**

**Programi:** Horizon Europe

**Përshkrimi:** Thirrja për projekt propozime FUTURAL ka për qëllim të përzgjedhë dhjetë projekte të reja për bashkë-krijimin e "Zgjidhjeve të Zgjuara" në bashkëpunim me komunitetet rurale. Kjo thirrje synon të përfshijë Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM), start-up-e, organizata kërkimore, me komunitetet rurale si bashkitë, autoritetet rajonale, agjencitë e zhvillimit dhe OJQ-të, që veprojnë në zonat rurale. Projektet duhet të përqendrohen në një nga pesë fushat:

Bio-Ekonomia qarkulluese, biodiversiteti dhe menaxhimi i ekosistemit

Qëndrueshmëria ndaj krizave

Angazhimi i qytetarëve dhe cilësia e jetës

Edukimi dhe trajnimi gjatë gjithë jetës

Përshtatja dhe zbutja e efekteve të klimës

**Konsorciumi:** FUTURAL pranon aplikime nga konsorciume të vogla të përbëra nga dy (2) deri në katër (4) palë, duke përfshirë  $\geq 1$  (të paktën një) palë teknike (p.sh., NVM, start-up, organizata kërkimore) dhe  $\geq 1$  (të paktën një) komunitet rural (p.sh., Bashkitë, Autoritetet Rajonale, Agjencitë e Zhvillimit, OJQ-të etj.).

**Shuma e grantit:** Financimi për çdo projekt varion nga 60,000 deri në 120,000 euro, me një buxhet total prej 1.2 milionë euro.

**Kriteret:** Propozimet duhet të përfshijnë partnerë nga shtetet anëtare të BE-së ose të asociuara me Horizon Europe, të kenë një numër të vlefshëm TVSH ose regjistrim të vlefshëm, dhe të adresojnë sfida të reja në zonat rurale. Zgjidhjet e propozuara duhet të jenë të ndryshme nga ato ekzistuese në projektet RURACTIVE dhe SMART ERA.

Propozimet do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

→ një person juridik themeluar në një vend të pranuar në Horizon Europe.

→ konsorciumi lejohet të paraqesë vetëm një propozim.

→ një palë mund të marrë pjesë vetëm në një konsorcium; Nëse një aplikant merr pjesë në më shumë se një propozim, atëherë të gjitha propozimet do të konsiderohen si të paranueshme.

→ Propozimet nuk duhet të jenë përzgjedhur paraprakisht në thirrjet e hapura të projekteve të tjera të financuara në bazë të të njëjtës temë RURACTIVE dhe SMART ERA.

→ Propozimi përfshin të paktën një palë teknike NVM, Start-ups, organizata kërkimore, etj) dhe të paktën një komunitet rural (p.sh. Bashkitë, Autoritetet Rajonale, Agjencitë e Zhvillimit, OJQ-të etj.);

→ zgjidhjet e propozuara përfshihen në një nga pesë sfidat në zonat rurale.

→ Zgjidhjet e propozuara duhet të jenë të ndryshme nga tetë (8) SS ekzistuese të zhvilluara brenda projektit FUTURAL siç përshkruhet në seksionin 1 të Udhëzuesit.

→ Zgjidhjet e propozuara duhet të aplikohen në zonat rurale, të ndryshme nga ato që mbulohen nga zonat ekzistuese të MAP-it siç përshkruhet në seksionin 1 të Udhëzuesit.

→ Të gjithë aplikantët duhet të kenë një numër të vlefshëm TVSH dhe duhet të jenë aktivë dhe funksionalë. Megjithatë, në rast se pasja e numrit të TVSH-së nuk është e detyrueshme sipas legjislacionit kombëtar të vendit të aplikantit, një numër regjistrimi nga shteti përkatës duhet të sigurohet nga autoritetet (Regjistri kombëtar i biznesit, gjykata tregtare ose të ngjashme).

**Afati i fundit për aplikim:** 30 shtator 2024, ora 17:00.

**Kohëzgjatja e zbatimit:** 12 muaj (Qershor 2025 - Maj 2026), e ndarë në tre faza: Projektimi, Zhvillimi, dhe Vlerësimi.

Link i thirrjes: <https://futural-project.eu/futural-open-call>